




REPUBLICA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
 AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
 AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
 ANTI-CORRUPTION AGENCY

Dep. 2-0/DPK
 Nr. Prot. 01-3360/13
 Br. Prot. 01-3360/13
 Prot. No. 01-3360/13
 Nr. i faq. 02
 Data 14.10.2013
 Broj stranica 02
 Datum 14.10.2013
 Nr. pages 02
 Date 14.10.2013
 PRISHTINE



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI-CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 29 paragrafi 1 pika e) të Rregullores së Punës të Agjencisë Kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë Kundër Korrupsionit me datë **08.10.2013**, nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me Nr. AKK-03-2624/13, për ztr. *Agim Sheqiri – Zyrtar kryesor financiar te Organi shqyrtues i prokurimit (OSHP), për shkak se është parandaluar situata e mundshme e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.*

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në ushtrimin e funksionit publik, nr. AKK-03-2624-13, për Zyrtarin e lartë, z. Agim Sheqiri – Zyrtar kryesor financiar te Organi shqyrtues i prokurimit (OSHP), dhe njëkohësisht person i autorizuar në një biznes privat, është trajtuar sipas procedurës së paraparë ligjore, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në ushtrimin e funksionit publik (Ligji Nr. 04/L-051).

Në rastin me numër protokoli AKK-03-2624/13, të hetuar për ekzistimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, zyrtari i lartë, z. Sheqiri së pari është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit, pas të cilës zyrtari është paraqitur në takim me zyrtarët e Agjencisë, me ç'rast është njoftuar me situatën në të cilën ndodhet si dhe me ndryshimet që duhet të bëjë për të parandaluar situatën e mundshme të konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit të tij publik.

Zyrtari i lartë, z. Sheqiri është deklaruar se do të heq dorë nga të qenurit person i autorizuar i biznesit privat, në mënyrë që të vazhdoi të ushtroj funksionin e tij publik, pa konflikt të mundshëm të interesit.

Ndërkohë z.Sheqiri në Agjenci ka dërguar një shkresë zyrtare bashkë me informacionin zyrtar të lëshuar nga Agjensioni për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (DPKI-03-3167/13), në të cilën shihet se ai ka hequr dorë nga funksioni i personit të autorizuar që kishte të ndërmarrja “Bekoma” sh.p.k., dhe tani nuk ka asnjë lloj funksioni në këtë ndërmarrje, për të ushtruar vet funksionin e tij si zyrtar kryesor financiar të Organi shqyrtues i prokurimit (OSHP).

II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë Kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./znj. (zyrtari kontaktues)

Drejtor i Agjencisë Kundër Korrupsionit

/ Hasan Preteni /

